

Kriza politike në vend ka hyrë në fazën finale. Dështimi eventual i presidentes Atifete Jahjaga që t'i bindë liderët e partive politike të arrijnë një marrëveshje për dalje nga kjo krizë, do ta bëjë të pashmangshme ndërhyrjen ndërkombëtare ose ndërhyrjen edhe një herë të Gjykatës Kushtetuese.

Në skenarin e dytë, Gjykata Kushtetuese do t'i jepte të drejtën presidentes që t'i shpallë zgjedhjet e jashtëzakonshme, derisa në skenarin e parë, me ndërhyrjen e ndërkombëtarëve, partitë do të mund të krijojnë një qeveri të përkohshme teknike.

Qeveria teknike, ose zgjedhjet e shpejta po shihen edhe si dy zgjidhjet e vetme, nëse palët nuk lëvizin nga qëndrimet.

Burime të gazetës bëjnë të ditur se kohëve të fundit po konsultohet një skenar që mund të shërbejë për kapërcimin e gjendjes, nëse PDK në njërin anë dhe blloku VLAN në anën tjetër, mbesin në pozicione të palëkundura.